



Pranuar / Dorezuar Puniljeno / Prodato Received / Delivery	23.12.0	viti god. year	
Organ / Njesia Org. / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicima Quantity
SKPMSTICK	3277/2020		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.340/2020

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga:Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit,kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.731/2019 të datës 22.11.2019, ankesën me numër A.nr.178/2020 të datës 02.07.2020, ankesën me numër A.nr.335/2020 të datës 28.10.2020 dhe ankesën me numër A.nr.340/2020 të datës 02.11.2020 të parashtruar nga ankuesi N.N me adresë rruga “Flamuri”, Nr. 256 në Komunën e Prizrenit, kundër organit të punësimit Komunës së Prizrenit, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës , në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 23.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.340/2020 e datës 02.11.2020 e parashtruar nga ankuesi N.N.

A r s y e t i m

Ankuesi N.N i punësuar sipas Akt emërimit të datës 30/06/2016 në pozitën “Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2” në Komunën e Prizrenit, më datë 15.12.2017 ka parashtruar kërkesë për ngritje të koeficientit në Zyrën e Personelit në Komunën e Prizrenit, po ashtu më datë 19.11.2018 ka parashtruar kërkesë tek Zyrtari Kryesore Financiar në Komunën e Prizrenit për kalim nga pozita “Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2” në pozitën “Zyrtar i të Hyrave Financiare”, ndërsa Zyrtari Kryesore Financiar në Komunën e Prizrenit kërkesën e ankuesit e ka përcjell tek Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, ndërsa Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa më datë 22.11.2018 këtë kërkesë e ka përcjell tek Shefi i Zyrës së Personelit dhe Kryetari i Komunës së Prizrenit.

Kryetari i Komunës së Prizrenit me datë 30.01.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. 01-112-14176 me të cilin ka bërë transferimin e përhershëm të ankuesit nga pozita “Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2” në pozitën “Zyrtar i të Hyrave Financiare”, ku në bazë të këtij vendimi i është bërë ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit të cilin ankuesi e ka nënshkruar më datë 30.01.2019.

Ankuesi, më datë 22.11.2019 nëpërmjet e-mailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë me numër protokoll 5498/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës më pretendimin për nivelizim të koeficientit në shtatë (7) sikurse për kolegët e tjerë brenda institucionit të njejtë.

Ankuesi, më datë 02.07.2020, 28.10.2020 dhe 02.11.2020 nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës më pretendimin për nivelizim të koeficientit në shtatë (7) sikurse për kolegët e tjerë brenda institucionit të njejtë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Komunën e Prizrenit. Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Prizrenit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto **prova**: Ankesën me numër protokoll 5498/2019 e datës 22.11.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokoll 1259/2020 e datës 02.07.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokoll 2305/2020 e datës 28.10.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokoll 2380/2020 e datës 02.11.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; CV-në e ankuesit; Njoftimin për kandidatët e suksesshëm i datës 01.06.2016; Akt Emërimit e datës 30.06.2016, 30.06.2017; Kërkesën për ngritje të koeficientit e datës 15.12.2017 nga ankuesi; Kërkesë e datës 19.11.2018 nga ankuesi; Kërkesë e datës 20.11.2018 nga Zyrtari Kryesor Financiar për Drejtorin e Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa; Kërkesë e datës 22.11.2018 nga Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa për Shefin e Zyrës së Personelit dhe Kryetarin e Komunës; Vendimin me Nr. 01-112-14176 i datës 30.01.2019; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 30.01.2019; Akt Emërimi i datës 04.01.2012; Certifikatë me Nr. 05-01/12 e ankuesit; Diploma e datës 03.11.2017 e ankuesit; Pasqyra e llogarisë nga Trusti për ankuesin; Konkurs për plotësimin e vendit të punës i datës 20.04.2016; E-mailin e datës 22.11.2019 nga ankuesi për ankesa.kpmschck@rks-gov.net; Listën nga katalogu i vendeve të punës në shërbimin civil të Kosovës; Përshkrimin e detyrave të punës “Zyrtar i të Hyrave Financiare”; Listat e pagave tetor 2020; Akt Emërimit për pozitën Gjeometër; Listën e pagave dhjetor 2018 dhe janar 2019 për Gjeometër; Akt Emërimit për pozitën “Zyrtar për Buxhet”; Listën e pagave dhjetor 2018 dhe janar 2019 për pozitën Zyrtar për Buxhet; Përgjigjen në ankesë e datës 21.02.2020, 22.07.2020 dhe 18.11.2020 të dërguara nga Komuna e Prizrenit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional, ndërsa pas zgjedhjes së pesë anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shqyrtimit të bazës ligjore, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mbledhjen e katërt të mbajtur më datë 09.11.2020 nxjerr Vendim me Nr. 9/2020 me të cilin është vendosur që të gjitha ankesat e dorëzuara dhe ato të kthyera në rishqyrtim nga gjykata do të vendosen nga Këshilli.

Në kuptim të kësaj Kryetari i Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave më datë 14.12.2020 ka parashtruar kërkesë për shtyrje të afatit për vendosje të ankesës me numër A.nr.340/2020 edhe për dhjetë (10) ditë pune. Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 14.12.2020 ka nxjerr Vendim me numër VK.nr.23/2020 me të cilin ka vazhduar afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.340/2020 së ankuesit N.N edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Meqenëse është vendosur që të shqyrtohen edhe ankesat e vitit 2019 atëherë Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.12.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. 4/2020 me të cilin ka vendosur që ankesa me numër A.nr.731/2019 e datës 22.11.2019, ankesa me numër A.nr.178/2020 e datës 02.07.2020, ankesa me numër A.nr.335/2020 e datës 28.10.2020 dhe ankesa me numër A.nr.340/2020 e datës 02.11.2020 të parashtruar nga ankuesi N.N të bashkohen në një ankesë për shkak se bazohen në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit N.N, është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që koeficienti për pozitën e tij të bëhet shtatë (7) sikurse kolegët e tjerë dhe jo gjashtë (6).

Ankuesi fillimisht ka themeluar marrëdhënie punë në Komunën e Prizrenit në bazë të Akt Emërimit të datës 30.06.2016 në pozitën “Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2” me koeficient pesë (5), mirëpo më datë 19.11.2018 ka parashtruar kërkesë tek Zyrtari Kryesore Financiar në Komunën e Prizrenit për kalim nga pozita “Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2” në pozitën “Zyrtar i të Hyrave Financiare”, ndërsa Kryetari i Komunës së Prizrenit me datë 30.01.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. 01-112-14176 me të cilin ka bërë transferimin e përhershëm të ankuesit nga pozita “Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2” në pozitën “Zyrtar i të Hyrave Financiare” me koeficient gjashtë (6). Në bazë të këtij vendimi ankuesit i është bërë ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit të cilin ankuesi e ka nënshkruar më datë 30.01.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi është pajtuar kushtet e themelimit të marrëdhënies së punës sipas koeficientit pesë (5) respektivisht me Ndryshim dhe Plotësim të Aktit të Emërimit të datës 30.01.2019 me koeficient gjashtë (6), mbi këtë bazë Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, gjegjësisht neni 9 paragrafi 1 përcakton se: *“Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës”*, rrjedhimisht ankuesi paguhet me koeficient sipas ndryshimit dhe plotësimit të aktit të emërimit.

Neni 7 paragrafi 1 dhe 1 i Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i cili përcakton: *“Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat”*, rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ligjërisht ngritja e koeficientëve për nëpunësit civil, mund të bëhet vetëm nëpërmjet procedurave ligjore e që duhet dëshkohet se institucioni ka planifikuar mjete buxhetore të miratuara nga ministria përgjegjëse për administratë publike respektivisht ministria përgjegjëse për financa.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka vlerësuar se ngritja e koeficientëve mund të behet vetëm nëpërmjet procedurave të lartcekura, atëherë pretendimet e ankuesit për ngritje të koeficientit në mënyrë automatike janë të pabazuara.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.340/2020, datë 23.12.2020

Aydyl Bekteshi


Procesmbajtës

Arben MEHMETI


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, N.N;
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

